

VENDIM
Nr. 271, datë 21.12.2018

MBI NDRYSHIMIN E AFATEVE TË RREGULLORES PËR “KRITERET STANDARDE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 181, DATË 10.11.2017

Në mbështetje të nenit 7, pika 1 dhe nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 104, pika 4; nenit 113, pikat 1 dhe 3 e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”; nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike “Mbi ndryshimin e afateve të rregullores për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, Bordi i ERE-s vendosi: miratimin e rregullores për “*Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike*”

- OSHEE sh.a., në shkresën me nr. 16891/1 prot., datë 28.9.2018, protokolluar me tonën nr. 575/1 prot., datë 1.11.2018 lidhur me implementimin e rregullores për “*Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike*”, ka kërkuar shtyrjen e afateve të përcaktuar në këtë rregullore, duke kërkuar një aplikim të përshkallëzuar për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarde të performancës në zona të ndryshme.

- Për të sqaruar më tepër problematiken e cituar nga “OSHEE” sh.a., dhe argumentet e sjella në funksion të kërkesës së tyre për shtyrjen e afateve, ERE në shkresën e saj me nr. 729 prot., datë 15.11.2018 ka njoftuar organizimin e një seance dëgjimore lidhur me diskutimin e të gjitha problematikave për të cilat kompania “OSHEE” sh.a., kërkon shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren “*Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike*”.

- Gjatë diskutimeve në seancë rezultoi se:

- Ka problematika në rrjetin e sistemit të shpërndarjes dhe mungesa të sistemit të matjes SMART, të cilat janë prioritet në zonat që kanë peshë specifike më të madhe për konsumin e energjisë elektrike.

- Si rezultat i sa më sipër “OSHEE” sh.a., thekson se është e paaftë për të përmbushur detyrimet sipas standardeve të shprehura në rregulloren e miratuar nga ERE me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017 dhe në këto kushte kërkon nga ERE rishikimin e rregullores duke u shprehur për një aplikim të përshkallëzuar, për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarde të performancës në zona si më poshtë:

- Zona: Tiranë–Durrës, afati i kërkuar – brenda datës 31.12.2020,

- Zona: Vlorë–Elbasan–Fier, afati i kërkuar – brenda datës 31.12.2021,

- Zona: Gjirokastër–Berat–Korçë, afati i kërkuar – brenda datës 31.12.2022,

- Zona: Shkodër–Burrel – Kukës, afati i kërkuar – brenda datës 31.12.2023.

Drejtoritë teknike të ERE-s duke shqyrtuar sa më sipër cituar nga kompania “OSHEE” sh.a., dhe duke evidentuar pamundësinë e realizimit të investimeve të domosdoshme e gjykon të arsyeshme shtyrjen e afateve për realizimin e parametrave të kërkuar nga “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, për një periudhë 6-mujore me kushtin që: brenda kësaj periudhe kompania të dorëzojë në ERE një studim të detajuar mbi përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuara sipas zonave të sipërcituara.

- Gjithashtu, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 798/1 prot., datë 19.12.2018, ka përcjelle problematikën e ndarjes së shoqërisë “OSHEE” sh.a., ku ndër të cilat më kryesoret që kanë lidhje me përcaktimin e tarifave, janë:

- Në zbatim të procesit të nisur të ndarjes së shoqërisë është e nevojshme të vijohet me ndryshime

nënligjore duke iu referuar një modeli tregu i cili do të ishte optimal jo vetëm për shoqërinë “OSHEE” sh.a., por edhe për operatorët e tjerë të energjisë.

- Nevojitet të përcaktohet operatori i energjive të rinovueshme jashtë shoqërisë “OSHEE” sh.a.

- T’i jepet zgjidhje problematikës së akomodimit në treg të sasisë së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (RES), që rezulton përtej nevojave për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

- Në vijim të etapave të mësipërme, nevojitet përcaktimi i buxheteve për dy shoqëritë: “OSSH” sh.a. dhe “FSHU” sh.a., gjë që do të mundësojë vlerësimin e të ardhurave të nevojshme për aktivitetet e rregulluara. Sa më sipër, ERE, me vendimin e Bordit nr. 264, datë 20.12.2018, vendosi përcaktimin e një periudhe tranzitore prej 12 muaj, për bërjen e efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), të shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.); miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018; licencës së furnizimit energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), të shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.) miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. nr. 215, datë 11.10.2018.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 7, pika 7.1, përkatësisht:

- data 31 dhjetor 2018 të ndryshohet me datën 30 qershor 2019.

2. Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 7, pika 7.2 aj, përkatësisht:

- data 31 dhjetor 2018 të ndryshohet me datën 30 qershor 2019.

3. Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 7, pika 7.3, përkatësisht:

- data 31 shtator 2018 të ndryshohet me datën 30 qershor 2019.

4. Ndryshimin e afatit të përcaktuar në nenin 10 pika 10.2, përkatësisht:

- data 1 janar 2019 të ndryshohet me datën 1 korrik 2019.

5. Kompania “OSHEE” sh.a. të dorëzojë në ERE një studim të detajuar mbi:

- “Përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuar nga rregullorja “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, brenda datës 1 korrik 2019.

6. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë OSHEE sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti